



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/36
Datë: 23.02.2026

Në bazë të Nenit 13 të Ligjit 03/1-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës: 29.9.2010, nenit 44 dhe 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 33 të Ligjit Nr.08/L-332 Mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe kërkesës me datë 23.02.2026 nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. Lejohet rritja e njësisë së koeficientit të pagës për zyrtaret publikë të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune me kontratë për periudhe të caktuar në Shërbimet e kujdesit social, shtëpiak dhe ambulatorë në Komunën e Junikut.
- II. Rregullimin e koeficientit sipas nenit 33 të Ligjit për ndarje Buxhetore për vitin 2025.
- III. Të behët kompensimi i diferencës së pa pagur duke filluar nga janari i vitit 2026.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset zyra e personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

ARSYETIM

Zyrtaret publikë të cilët themelojnë marrëdhënie pune me kontrate për periudhe të caktuara gëzojnë të drejtat dhe detyrimet e njëjta sikurse të gjithë nëpunësit, andaj duke u bazuar në këtë fakt është paraparë që të bëhet rregullimi i koeficientit duke u bazuar në rritjen e njësisë së koeficientit të aplikuar në dy faza në rritje prej zero pike (0.5) njësi të koeficientit duke filluar nga muaji janar i vitit 2025, ndërsa rritja tjetër prej zero pike pesë njësi e aplikuar nga muaji korrik 2025.

Bazuar në periudhën e themelimit të marrëdhënies së punës të behët rregullimi i koeficientit, sipas nenit 33 të Ligjit Nr.08/L-332 Mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Të njoftohen:

- Drejtorisë për SHMS;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
- Zyra e personelit;
- Arkivi.

